

## NJOFTIMI PËR REGJISTRIMIN E GJUHËS ANGLEZE

I dashur Prind / Kujdestar:

Kjo letër është për t'ju informuar se fëmija juaj \_\_\_\_\_,  
Nxënës ID# \_\_\_\_\_ është testuar në testin "WIDA" në gjuhën Angleze në  
\_\_\_\_\_ dhe ka arritur rezultatin \_\_\_\_\_, rezultat i cili e identifikon atë  
si Nxënës që Mëson Anglisht (EL) dhe do të marrë shërbime gjuhësore nëpërmjet Programit  
Edukativ Mësimor për gjuhën (LIEP) i njohur zakonisht, Anglishtja si Gjuhë e Dytë (ESL).

Qëllimi i **LIEP** është të ndihmojë fëmijën tuaj të mësojë gjuhën angleze në mënyrë që ai / ajo të jetë  
në gjendje të plotësojë standartet akademike të përshtatëshme për moshën, dhe të marrin të gjitha  
kreditë e duhura për diplomim. Për të dalë nga **LIEP**, fëmija juaj duhet të plotësojë kriteret e  
Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë për riklasifikim. Drejtoria Arsimore e Filadelfias shqyrton  
përformancën e secilit fëmijë çdo vit për të përcaktuar nëse fëmija ka të drejtë për riklasifikim. Ju mund  
t'i shikoni kriteret për riklasifikim në faqen e internetit të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë në  
<https://www.education.pa.gov/>.

Nën ligjin federal "**Every Student Success Act**" (**ESSA**), disa nxënës mund t'ju ofrohen shërbime  
plotësuese kur janë në dispozicion. Këto shërbime mund të përfshijnë mësimdhënie, programim në  
internet, programe pas-shkollore dhe verore. Prindërit e EL-ve kanë të drejtë të refuzojnë këto  
shërbime dhe gjithashtu kanë të drejtë të refuzojnë disa programe të veçanta mësimore që mund të  
jenë pjesë e **LIEP**-së së fëmijës suaj. Nëse dëshironi të refuzoni shërbimet ose të bëni pyetje të tjera  
rreth **LIEP**, ju lutemi kontaktoni drejtorin e shkollës suaj për të caktuar një takim me përfaqësues të  
Zyrës së Programeve dhe Kurrikulës Shumëgjuhëshe (OMCP).

Ne shpresojmë në punën e përbashkët për mbështetjen e arritjeve akademike të fëmijës suaj.

Sinqerisht,

\_\_\_\_\_  
Emri i administratorit të testit

\_\_\_\_\_  
Titulli i Administratorit të Testit

\_\_\_\_\_  
Firma e Administratorit të testit

\_\_\_\_\_  
Data

## **PYETJE MË TË SHPESHTA**

### **1. Cili vlerësim vjetor përdoret për të testuar aftësitë në gjuhën angleze të fëmijës tim?**

ACCESS për vlerësimin ELs® përdoret çdo vit për të përcaktuar aftësinë angleze të fëmijës suaj. Ky vlerësim jepet në mes të Janarit dhe Shkurtit të çdo viti shkollor dhe administrohet qoftë online ose me letër dhe laps. Nxënësit marrin një rezultat prej 1.0 - 6.0 (6.0 është më i lartë).

### **2. Çfarë saktësisht është testuar në ACCESS për vlerësimin ELs®?**

Fëmija juaj vlerësohet për aftësitë në gjuhën angleze në leximi, shkrim dëgjim dhe në të folur. Secila nga këto gjenerojnë në një rezultat që së bashku krijojnë një rezultat të përgjithshëm të përbërë, i njohur gjithashtu si niveli i aftësisë angleze të fëmijës suaj. Çdo fushë ( lexim, shkrim, dëgjim dhe i foluri) përfshijnë pyetje rreth studimeve shoqërore, shkencës, matematikës dhe artit gjuhësor.

### **3. Do të njoftohem për performancën vjetore të fëmijës tim në vlerësimin ACCESS për ELs®?**

Po, do të njoftoheni në fund të çdo viti shkollor për ecurinë e fëmijës suaj në vlerësimin ACCESS për ELs®. Një raport ose do të postohet me postë në adresën që shkolla ka në dosje, ose raporti do t'i jepet fëmijës suaj për t'ju dorëzuar.

### **4. Si mund të mësoj për përparimin e fëmijës tim në rritjen e aftësisë në gjuhën angleze gjatë gjithë vitit shkollor?**

Gjatë vitit shkollor do të merrni raporte të përkohshme mbi ecurinë e fëmijës suaj nga ana akademike. Prindërit / kujdestarët inkurajohen gjithashtu të marrin pjesë në konferencat prindër/mësues në fund të çdo periudhe të caktuar. Drejtoria Arsimore e Filadelfias ofron tre (3) konferenca prindër/mësues gjatë gjithë vitit shkollor. Ju lutemi, takoni mësuesin e fëmijës suaj për këto data.

### **5. Sa shpejt mundet fëmija im të mësojë shumë mirë anglisht dhe të dalë nga LIEP?**

Disa faktorë ndikojnë në normën në të cilën nxënësit mësojnë anglisht. Këto përfshijnë moshën e nxënësve, përvojën e mëparshme në Anglisht, aftësitë e gjuhës dhe shkrim-leximit në gjuhën e nxënësit. Për nxënësit që hyjnë në shkollë me pak ose aspak aftësi në gjuhën angleze, qëllimi është të arrihet aftësia brenda gjashtë viteve shkollore. Nxënësit që fillojnë në nivele më të larta të aftësisë angleze duhet të fitojnë aftësi në gjuhën angleze më shpejt. Megjithatë, përparimi i secilit nxënës është unik dhe mësuesit konsiderojnë disa faktorë kur monitorojnë rritjen e rezultateve të nxënësve në mësimin e gjuhës angleze. Ne inkurajojmë prindërit / kujdestarët që të diskutojnë përparimin e fëmijës së tyre në mësimin e gjuhës angleze gjatë shpërndarjes së dëftësive shkollore në konferencat prindër/mësues, ose duke njoftuar për një takim me mësuesin/mësuesen e fëmijës së tyre.

### **6. Kë duhet të takoj nëse fëmija im ka probleme në shkollë?**

Të gjitha shqetësimet lidhur me fëmijën tuaj duhet të diskutohen me mësuesin e fëmijës suaj. Në mungesë të mësuesit, gjithashtu mund të komunikoni me Drejtorin e shkollës. Për të gjetur informacionin e kontaktit të Drejtorit tuaj, vizitoni <https://www.philasd.org/directory/school-directory/>

### **7. Çfarë bëhet nëse fëmija im ka një paaftësi?**

Nëse fëmija juaj ka një aftësi të kufizuar dhe është gjithashtu në programin, Anglishtja si gjuhë e dytë, ai /ajo do të marrë edhe shërbime të gjuhës angleze dhe shërbime të edukimit special. Këto shërbime do të dokumentohen në programin e edukimit të individualizuar të fëmijës suaj, ( IEP), dhe do të rishikohen çdo vit nga një ekip IEP që përfshin edhe një person të programit ESL( gjuha angleze si gjuhë e dytë. Prindërit duhet gjithashtu të marrin pjesë në këto mbledhje vjetore të rishikimit të IEP-së. Përveç kësaj, grupi i IEP së fëmijës suaj do të punojë në bashkëpunim gjatë gjithë vitit shkollor për të siguruar që programet mësimore të zbatohen sipas nevojave të fëmijës suaj. Për më shumë informacion rreth shërbimeve të Edukimit Special të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, ju lutemi kontaktoni drejtorin e shkollës ose vizitoni <https://www.philasd.org/specializedservices/>.

### **8. Si mund të përfshihem më shumë në shkollën e fëmijës tim?**

Një mënyrë që ju mund të përfshiheni më shumë në edukimin e fëmijës suaj është Këshilli Konsultiv i Shkollës (SAC) i shkollës suaj. Ky këshill - i përbërë nga prindër, mësues, nxënës dhe anëtarë të komunitetit - ndihmon udhëheqjen e shkollës në planifikimin për përmirësimin e rezultateve të shkollës dhe vendimet që merren. Dokumentet e përkthyer dhe shërbimet e interpretimit ofrohen për anëtarët me aftësi të kufizuar në gjuhën angleze; gjuha nuk duhet të jetë pengesë për pjesëmarrjen në SAC. Drejtoria Arsimore gjithashtu organizon takime me prindër nëpërmjet "Welcome Wagon" në pjesë të ndryshme të qytetit gjatë gjithë vitit shkollor. Për më shumë informacion rreth këtyre ngjarjeve, ju lutemi vizitoni faqen e zyrës së " Family and Community Engagement ( FACE) në websajtin <https://www.philasd.org/face/>.

### **9. Ku mund të gjej më shumë informacione?**

Për të mësuar më shumë si një prind që fëmija e tij është në programin, Anglishtja si gjuhë e dytë vizitoni <https://wida.wisc.edu/teach/learners/engagement>. Për të mësuar më shumë rreth Zyrës së Kurrikulës dhe Programeve Shumëgjuhëshe të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias, vizitoni <https://www.philasd.org/multilingual/>.